Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
<u>Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....</u>
<u>Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)</u>
<u>Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)</u>
<u>Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)</u>

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve**OBJEKTI: “BLERJE DHE INSTALIM POMPA UJI”**

1	2	3	4	5	6
Arti kulli	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total për artikull (4 x 5X)
1	Pompa uji binjake horizontale me karakteristikë: Q=2 m ³ /h x 2; H=36,6 m; P=0.55 kW, 230, 50Hz	copë	2		
2	Pompa uji binjake horizontale me karakteristikë: Q = 4,3 m ³ /h x 2; H = 40,4 m; P=1.1 kW, 1x 230V, 50Hz	copë	5		
3	Pompa uji binjake horizontale me karakteristikë: Q=6 m ³ /h x 2; H=42,8 m; P=1.5kW; 230/400 V; 50Hz	copë	2		

4	Pompa uji binjake vertikale me karakteristika: Q=6,26 m ³ /h x2; H=50,6 m; P=1.5kW; 230/400V; 50Hz	copë	1		
5	Panel Kontrolli: 1~230V; 50/60 Hz; P-0.37÷2.2 kW; HP-0.5÷3; I-2A-16 A	copë	7		
6	Panel Kontrolli: 3~400V;50 Hz; P -0.55÷7.5 kW; HP-0.5÷3; I-2A-15 A	copë	3		
7	Ene zgjeruese, 80 l , 10 Bar, -10/+99°C	copë	7		
8	Ene zgjeruese 100 l , 10 Bar, -10/+99°C	copë	3		
9	F.v. rezervuari zingato 5.000 litra	copë	3		
10	Galexhant elektrik: Temp. punes - 0/+50°C, Kendi i aktivizimit ±45°, IP68	copë	10		
11	F.v. saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	copë	20		
12	F.v. saracineska bronzi Ø 1e 1/4 " = 32 mm	copë	20		
13	F.v. presostate 5 Bar	copë	18		
14	F.v. presostate 12 Bar	copë	2		
15	F.v. kabull (Cu) 4 x 2.5mm ²	ml	64		
16	F.v. kabull (Cu) 3 x 2.5mm ²	ml	100		
17	F.v. filter 1-2"	copë	18		
18	F.v. kondra valvulë 1"	copë	18		
19	F.v. kondra valvulë 1e 1/4"	copë	2		
20	F.v. tapë deri 1,5"	copë	10		
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH:					
TVSH (20%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikime teknike

1. Grup pompimi horizontal monofaze

Konstruksion standart, centrifugale

Motor elektrike monofaze (230V)

Toleranca e lejuar e tensionit -10% / 10%

Numri i rrotullimeve 2760- rrot/min

Te gjitha pjeset hidraulike te Pompës: (Inox) çelik i pandryshkshëm AISI 304 ose ekuivalente

Materiali i rotorit: grafi karboni (Ca) i ngopur me rezin

Materiali i statorit: qeramik (Ce) oksid alumini

Materiali i gomines se permistopit NBR

Lidhjet: fole te filetuara DIN-ISO 228-1 ose ekuivalente;

Q=2 m³/h x 2 H=36,6 m, 230V, 50Hz

Temperatuar max. e ujit 60 gradë celsius;

Efienca e Pompës: 45 %

Garancia 1 vit

2. Grup pompimi horizontal monofaze

Konstruksion standart, centrifugale

Motor elektrike monofaze (230V)

Toleranca e lejuar e tensionit -10% / 10%

Numri i rrotullimeve 2790- rrot/min

Te gjitha pjeset hidraulike te Pompës: (Inox) çelik i pandryshkshëm AISI 304 ose ekuivalente

Materiali i rotorit: grafi karboni (Ca) i ngopur me rezin

Materiali i statorit: qeramik (Ce) oksid alumini
Materiali i gomines se permistopit NBR
Lidhjet: fole te filetuara DIN-ISO 228-1 ose ekuivalente;
 $Q = 4,3 \text{ m}^3/\text{h} \times 2$; $H = 40,4 \text{ m}$; 230V, 50Hz
Temperatuar max. e ujit 60 gradë celsius;
Eficienca e Pompës: 55.1 %
Garancia 1 vit

3. Grup pompimi horizontal monofaze

Konstruksion standart, centrifugale
Motor elektrike monofaz (220-230V)
Numri i rrotullimeve 2800- rrot/min
Materiali i boshtit: çelik i pandryshkshëm AISI 304 (Inox) ose ekuivalente
Materiali i elikes: çelik i pandryshkshëm AISI 304 (Inox) ose ekuivalente
Materiali i rotorit: grafi karboni (Ca) i ngopur me rezin
Materiali i statorit: qeramik (Ce) oksid alumini
Materiali i gomines se permistopit NBR
Standarti i lidhjes: DIN-ISO 228-1 ose ekuivalente;
 $Q=6 \text{ m}^3/\text{h} \times 2$; $H=42,8 \text{ m}$; 230/400 V; 50Hz
Temperatuar max. e lëngut 60 gradë celsius;
Eficienca e Pompës: 60 %
Klasifikimi i ngjyres: RAL5002 ose ekuivalente
Garancia 1 vit

4. Grup pompimi vertikal trefazor

Thithje dergim ne nje linje(in line)
Motor elektrike tre fazor me rregjim tensioni (230/400V)
Toleranca e lejuar e tensionit -10% / 10%
Numri i rrotullimeve 2925- rrot/min
Te gjitha pjeset hidraulike te Pompës: (Inox) çelik i pandryshkshëm AISI 304 ose ekuivalente
Materiali i rotorit: grafi karboni (Ca) i ngopur me rezin
Materiali i statorit : karbur silici (Sic)
Materiali i gomines se permistopit EPDM
Lidhjet: fole te filetuara DIN-ISO 228-1 ose ekuivalente;
 $Q=6,26 \text{ m}^3/\text{h} \times 2$; $H=50,6 \text{ m}$; 230/400V; 50Hz
Temperatura max. e lëngut 140 gradë celsius;
Eficienca e Pompës: 66 %
Garancia 1 vit

5. Panel kontrolli:

Paneli i ketij sistemi eshte i pajisur me mbrojtjet baze termike si dhe siguresa mbrojtese.
Paneli ben funksionimin automatik te pompave dhe alternimin e tyre ne baze te kerkeses .
Ne kapakun e panelit ka treguesit kryesor te funksionimit si:

Me ngjyre jeshile -sinjali i pranise se tensionit,
Me ngjyre te kuqe -sinjali i galexhantit elektr per fikjen e pompave kur depozitat nuk kane uje.
Me ngjyre te kuqe -releja termike e cdo elektromotori.
Auto – 0 - Manual -pulsantet per sejcilen elektropompë .
Mbrojtja IP 54
Temperature pune ambjenti -5 deri +40 grade celcius
Lageshtire relative ambjenti 50%

6. Karakteristika teknike te panel kontrolli te grupeve te pompave:

Paneli i grupit te pompave te jetë i pajisur me :

- mbrojtje baze termike
- siguresa mbrojtese.
- funksionimin automatik te pompave
- alternimin e tyre ne baze te kerkeses .

Ne kapakun e panelit te kete treguesit kryesor te funksionimit si:

Me ngjyre jeshile -sinjali i pranise se tensionit,
Me ngjyre te kuqe -sinjali i galexhantit elektr per fikjen e pompave kur depozitat nuk kane uje.
Me ngjyre te kuqe -releja termike e cdo elektromotori.
Auto - 0- Manual -pulsantet per secilen elektropompë .

Specifikimi i Materialeve: janë dhënë më sipër.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë. Të gjitha mallrat duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe markën e prodhuesit.

Furnizimi bëhet me mjetet e furnizuesit sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në kontratë në vendodhjen e përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Instalimi i pompave binjake do të realizohet nga operatori ekonomik ofertues, i cili do të marrë përsipër dhe kthimin në gjendjen e mëparshme të prishjeve të muraturave, linjave hidraulike ekzistuese, linjave elektrike ekzistuese etj., të cilat do të jenë të nevojshme për instalimin mekanik dhe elektrik të pompave te ujit. Depozitat e ujit 5.000 litëshe do të jenë çelik me zikim në të nxehtë (në përshtatje me vendin ku do të instalohen mund të kërkohet vertikale ose horizontale), Gjatë zbatimit të instalimeve do të përmbushen kushtet teknike të zbatimit KTZ dhe rregullat e sigurimit teknik në punë.

Mallrat e furnizuara dhe instaluara do të provohen në ngarkesë në prani të komisionit të marrjes në dorëzim. Mallrat **do të ofrohen me një afat garancie jo më pak se 12 muaj** nga data e lëvrimit. Kushtet e garancisë së mallrave do të përcaktohen me marrëveshje mes palëve.

Kushte të tjera të detyrueshme:

- Pompat binjake do të dorëzohen të instaluar në objektet arsimore apo të tjera, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi i pompave binjake ose nga Distributori i Autorizuar që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve, për një periudhë jo më pak se 1 vit.
- Në çmim janë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, transporti, çmontimi i linjave hidraulike dhe elektrike ekzistuese, instalimi mekanik dhe elektrik, prova me ngarkesë me dalje uji të hapura (lavamane, kaseta banjo etj.).
- **Shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen pa pagesë për vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimit mirëmbajtës nga autoriteti kontraktor).**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Pompa ujë binjake dhjetë komplete përfshirë aksesorët për instalim (montim në objekte).

Afatet e lëvrimit:

Afatet e lëvrimit: 30 ditë, mbas nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma ne total	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Pompa ujë binjake	Pompa ujë bijake të kompletuara me panele komandimi dhe të gjithë aksesorë e tjerë hidraulik dhe elektrik për furnizimin nga depozitat në daljet e ujit (lavamane etj.) në objekte arsimore në administrim të Bashkisë Tiranë	10	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë Objektet përcaktohen në	Nga daat e nënshkrimit të kontratës 30 ditë.

			kontratë.	
--	--	--	-----------	--

Shenim: Formulari i sasisë sipas objekteve bashkëlidhur DST.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të

përfiturar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale e cila të përmbajë kategoritë, sipas modelit të lëshuar nga MPPT:

- ❖ NS -2 (A) Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtje e tyre.
- ❖ NS -14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiofoni etj.

2.1.2 Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me ISO 41001:2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të objekteve, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar). Enti çertifikues për lëshimin e çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar ose organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike çertifikatat janë të detyrueshme për të gjithë operatorët sipas llojit dhe sasisë së furnizimeve/shërbimeve.

3.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

3.2.1) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

3.2.2) Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

3.2.3) Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë*

AK, para shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

4. Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre inxhinieret dhe specialistet e mëposhtem të cilet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën minimumi Janar 2023-Shkurt 2023:

- 1 (një) Ing. Mekanik
- 1 (një) Ing. Elektrik

Inxhinieret e kerkuar me siper bazohen ne furnizimin dhe instalimin profesional qe ky produkt kerkon.

- 2 (dy) specialiste hidraulik sipas kodit te punes dhe te pajisur me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar ne Shqiperi.
- 1 (një) specialist elektricitist sipas kodit te punes dhe te pajisur me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar ne Shqiperi.
- 1 (një) specialist saldator me deshmi kualifikimi nga organizem i akredituar ne Shqiperi.

Për inxhinieret duhet të paraqiten kontrata e punës dhe diploma, kurse për specialistët listepagesa dhe dëshmitë e kualifikimit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje “Dokumentin e Vleresimit te Riskut (DVR)”, ne pajtim me Ligjin nr 10237, date 18.02.2010 “Per sigurine dhe Shendetin ne Pune”, i ndryshuar, sipas fushes se objektit te veprimtarise. (ne rast bashkimi operatoresh ekonomike, mjafton disponueshmeria e 1 DVR per te gjithe BOE)

(Ky kriter 4 disponimi i specialistëve teknikë për objektin e këtij prokurimi) konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor)

5.1 Kapaciteti teknik:

5.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 5.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributor i autorizuar të mallrave objekt prokurimi – pompa uji - të përshkruara në Specifikimet Teknike kjo e vertetuar nepermjet dokumentave origjinalë (ose të njehsuar me origjinalin) si perfaqesues i kompanise prodhuese. Ne rast paraqitje autorizimi nga distributori zyrtar operatori ekonomik duhet të paraqesë akt marreveshje (origjinale ose e njehsuar me origjinalin), midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme, midis tyre. Autorizimi duhet të permbaje të dhena të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
- 5.1.3 Të gjithë mallrat sipas objektit të prokurimit duhet të përmbushin standartet Europiane të konformitetit sipas normativave CE. Te paraqitet deklarate e performances e mallit objekt prokurimi- pompa/pompa binjake ujë- dhe raport testimi. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve të mallrave të përshkruara në Specifikimet Teknike. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklarate konformiteti nga prodhuesi per produktin pompe uji.
- 5.1.4 Nje certifikatë nga prodhuesi ose distributor i autorizuar, që deklaron se produkti – pompë/pompa binjake uji është pa kimikate të rrezikshme, nuk përmban elemente gërryes, oksidues, radioaktive, toksike etj..
- 5.1.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira/ose mbështetje nga një operator ekonomik. Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Leje Qarkullimit, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, Akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme), ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë ose një deklaratë mbështetje nga një operator ekonomik ku të deklarohet se mbështetja e tij për këtë kapacitet teknik ofrohet për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Leje Qarkullimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme).

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

(Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperprane AK jo me vone se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

•
nformacion mbi subjektet

mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në

fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit
